

# AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

## “ERG Construction” sh.p.k

Fier më datë 16/02/2023

### NENI 1

Shoqëria Tregtare “**ERG Construction**” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statuti të miratuara prej saj.

### NENI 2

#### Emri i Shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin “**ERG Construction**” sh.p.k

### NENI 3

#### Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimi te veprimtarisë:

- 1) Punime te ndryshme ne fushen e ndertimit, punime gipsi, bojaxhi, shtrime pllakash, suvatime, konstruksion dhe riparime ndertesash.
- 2) Eksport- Import dhe tregtimi me shumice dhe pakice i mallrave te ndryshem ne fushen e ndertimit

### NENI 4

#### Selia e Shoqërisë

- 1) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresë: Fier, Lagjja "15 Tetori", Rruga "Todi Shkurta", zona kadastrale nr. 8533, pasuria nr. 4/113
- 2) Adresat e komunikimit elektronik të shoqërisë janë: [ergconstruction2023@gmail.com](mailto:ergconstruction2023@gmail.com)

### NENI 5

#### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 100.000 lekë. Kapitali ndahet në 1 (nje) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

- 1) Artan Karçini në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100 % të vlerës së kapitalit themeltar, e barabartë me 1 kuotë me vlerë 100.000 Lekë.

Kapitali themeltar investohet nga ortaku themelues në para. Pagesa e kapitalit themeltar kryhet nga Ortakët themelues mbas rregjistrimit ne Qëndren Kombëtare të Biznesit.



**NENI 6**  
**Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

**NENI 7**  
**Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008” Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- 1) Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
- 2) Administrator – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i shoqërisë është z. Artan Karçini lindur më 01.05.1968 në Fier Shqipëri dhe banues ne Fier Shqipëri, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit nr.033724475 dhe nr. personal G80501033K  
cel.0692021148

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

**NENI 8**


Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë.

**NENI 9**

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

**NENI 10**

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

*Anton Rammo*  


## NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

## NENI 12

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshje që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

## NENI 13

### **Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

## ***ORTAKËT***

### ***E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR***

#### **ERG Construction**

1.Ortaku i vetëm themelues Artan Karçini

*Anton Karçini*

